



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 42
Prishtinë, më 23 shkurt 2017, në orën 11:30
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Synavere Rysha, Naim Fetahu dhe Enver Hoti.

Munguan: Fikrim Damka dhe Bali Muharremaj.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, GIZ.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 16.2.2017;
3. Shqyrtimi i amendamenteve të Komisioneve të Përhershme për Projektligjin nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
4. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 16.2.2017

Kryetari konstatoi se procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 16.2.2017, u miratua pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i amendamenteve të Komisioneve të Përhershme për Projektligjin nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët se në amendamentet tona, për sa i përket Projektligjin nr.05/L-122, për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, kanë dhënë vërejtje Komisioni për Legjislacion si dhe Komisioni për Buxhet dhe Financave, si komisione të përhershme. Vlen të theksohet se Komisioni për Legjislacion ka rekomanduar që të rishikohet amendamenti 11 i Komisionit Funkcional, teksti i cituar : “Projektligji nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm, me përjashtim të amendamentit 11. Dhe pika 2 i rekomandohet Komisionit Funkcional që ta rishikojë amendamentin 11”. Sipas kësaj i bie që amendamenti 11 i Komisionit Funkcional të fshihet në tërësi apo të rishikohet. Kjo për faktin se në këtë amendament jemi mundu me i rregullua pagat e drejtorëve të Njësive të Auditimit, Stafit të Njesisë Qendrore Harmonizuese, Njësive të Auditimit në Institucione dhe Auditorëve të Brendshëm.

Po ashtu, fokusi i Komisionit për Legjislacion është edhe në pikën 4 të amendamentit 11, ku flitet për pagën e auditorëve në ndërmarrjet publike në nivel lokal. Thënë të drejtën, mendoj se Komisioni për Legjislacion është dashtë të jep mendimin e vetë se si do të duhet të jetë amendamenti e jo të thuhet se ky amendament është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

Po ashtu, Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka dhënë vërejtje në Projektligj, fillimisht si dhe në amendamentet e KMFP-së më pastaj, siç vijon “ Projektligji nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, propozon amendament në Projektligjin nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, si vijon: Neni 23, pas paragrafit 1, shtohen dy paragrafë të rinj 2 dhe 3, me tekstin si vijon: Paga e drejtorit të NJQH-së dhe paga e drejtorit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, rregullohet në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil. Paga e udhëheqësit të NJQH-së për auditim të brendshëm, paga e udhëheqësit për Menaxhim Financiar dhe Kontroll, paga e stafit të NJQH-së dhe paga e auditorëve të brendshëm, rregullohet në pajtim me legjislacionin e shërbimit civil. Andaj, bazuar në atë që u tha me lartë, mbetet të kuptohet se Ligji i Shërbimit Civil, nuk e ka rregulluar asnjëherë pagën e auditorëve. „Pagat e drejtorit të NJQH-së, Stafit të NJQHA-së dhe auditorëve të brendshëm, të trajtohen në mënyrë të veçantë dhe të jenë të barabartë me pagat e auditorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit ”.

Me këtë hapi diskutimin.

Ali Sadriu, tha se ne si komision e kemi kryer punën në momentin e përgatitjes së amendamenteve nga KMFP-ja, si Komision FunkSIONAL, ndërsa tani propozoj që orientimi i komisionit të jetë vetëm se çka kanë propozuar Komisionet e Përhershme.

Abdyl Ymeri, theksoi po ashtu se pjesa e arsytimit tek Komisioni i Legjislacionit për sa i përket amendamenti 11 të Komisionit FunkSIONAL, është i qëlluar. Ne duhet të kemi parasysh se nëse nuk i marrim rekomandimet e Komisionit për Legjislacion dhe Komisionit të Buxhetit atëherë ekziston mundësia që amendamentet tona të mos kalojnë në seancë plenare.

Faton Topalli, kryetar, tha se ne kemi një propozim për një amendament të ri, i cili mund të jetë i ngjashëm me amendamentin fillestar të dhënë fillimisht i cili është siç vijon: Paga e drejtorit të Njesisë Qendrore Harmonizuese, pagat e drejtorëve të Njësive të Auditimit të Brendshëm, Stafit të Njesisë Qendrore Harmonizuese dhe auditorëve të brendshmen, të trajtohen në mënyrë të veçantë dhe të jenë të harmonizuara me pagat e auditorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Synavere Rysha, theksoi se ne e përkrahim si komision propozimin e ri, të cilin do ta dërgojmë në komisionet e përhershme. Mendoj se paga e auditorëve duhet të mbrohet me çdo kusht.

Hajdar Beqa, tha se duhet të merret për bazë rekomandimi i Komisionit për Legjislacion, sa i përket amendamenti 11 të Komisionit FunkSIONAL. Ndërsa, amendamenti i Komisionit të Buxhetit, sa i përket pagave duhet të rishikohet sipas propozimit të kryetarit të KMFP-së.

Faton Topalli, kryetar, propozoi që të paraqitet rekomandimi i ri me këtë përmbajtje: Paga e drejtorit të Njesisë Qendrore Harmonizuese, pagat e drejtorëve të Njësive të Auditimit të Brendshëm, stafit të Njesisë Qendrore Harmonizuese dhe auditorëve të brendshëm të trajtohen në mënyrë të veçantë dhe të jenë të harmonizuara me pagat e auditorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që të dërgojë amendament tjetër të ri në komisionet e përhershme, sa i përket pagave të auditorëve me këtë përmbajtje: Paga e drejtorit të Njesisë Qendrore Harmonizuese, pagat e drejtorëve të Njësive të Auditimit të Brendshëm, Stafit të Njesisë Qendrore Harmonizuese dhe auditorëve të brendshëm, të trajtohen në mënyrë të veçantë dhe të jenë të harmonizuara me pagat e auditorëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

4. Të ndryshme

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët se sot, në orën 13:00, do të mbledhet grupi punues me përfaqësues nga GIZ-i, ZKA-ja dhe stafi i komisionit, për të përgatitur planin, për të analizuar raportet e auditimit të komunave për vitin 2015, për 7 regjione, duke përfshi edhe Komunën e Graçanicës.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që administrata e komisionit të përgatisë një plan për të analizuar raportet e auditimit të komunave për vitin 2015. Në mbledhjen e radhës së KMFP-së, plani duhet t'i paraqitet Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli